



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:221134

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 06030970

C.nr. 2021:221135

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha si gjyqtar individual, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, duke vendosur në çështjen kontestimore-juridiko civile të paditësit B. L. nga fshati ..., komuna Hani i Elezit, të cilin me autorizim i përfaqëson Avokat D. R. nga Kaçaniku, kundër të paditurit B. L. 1 nga fshati ..., komuna Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat A. H. nga Ferizaj, për çështjen kontestuese Vërtetimi i Pronësisë, në seancën kryesore publike, të mbajtur më datën 05.06.2024, në praninë e paditësit Bajrush Laçi, të autorizuari të tij, të të paditurit B. L. 1 si dhe të autorizuarit të tij, merr dhe shpall, ndërsa më datë 05.07.2024 përpiloi me shkrim të këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B. L. nga fshati ..., komuna Hani i Elezit, si e BAZUAR dhe VËRTETOHET se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e posedimit me mirëbesim në pjesën e parcelës kadastrale ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 168m<sup>2</sup>, e cila sipërfaqe përbëhet nga 96m<sup>2</sup> e cila është e shtruar me kubëza betoni dhe 72m<sup>2</sup> sipërfaqe e cila shfrytëzohet si oborr, që gjindet në Z.K ..., e regjistruar në emër të të paditurit B. M. L.

**II. REFUZOHET** Pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B. L. nga Hani i Elezit me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë për pjesën prej 55m<sup>2</sup> të parcelës kadastrale ... Z.K ... e cila përbën sipërfaqen e gërmuar për nivelizimin e rrugës, e cila po ashtu është në pronësi të B. L. dhe vazhdon të mbetet si e tillë edhe në të ardhmen.

III.DETYROHET i paditurit që të ia njoh të drejtën e pronësisë paditësit si në pikën -I- të këtij dispozitivi, në të kundërtën ky aktgjykim do të shërbej si titull juridik për regjistrim në regjistrat kadastral, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

IV. Gjykata vendosi që secila palë ti përballon shpenzimet e procedurës kontestimore, ndërsa konstatohet se pala paditëse e ka paguar taksën prej 20€ në emër të taksës për padi.

### **A r s y e t i m**

Gjykata ka pranuar më datën 30.09.2021, padinë nga pala paditëse B. L. ndaj të paditurit Bajram Laçi, që të dy nga fshati ..., komuna Hani Elezit, lidhur me çështjen kontestuese fitimi i të drejtës së pronësisë me mbajtje për pjesë të caktuar të paluajtshmërisë.

#### **1. Juridiksioni dhe kompetenca e Gjykatës.**

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil. Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë të nenit 17.2 të LPK-së: “Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”. Meqenëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia juridiko – civile, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Lidhur me kompetencën territoriale në bazë të nenit 41.1 të LPK-së: “Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria”. Duke qenë se paluajtshmëria kontestuese ndodhet në territorin e Komunës së Hani të Elezit, rezultoi se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile është kjo gjykatë.

## 2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me padi, përmes të autorizuarit të tij në seancat e mbajtura gjyqësore, si dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që ta miratoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe të vërtetohet se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje në pjesën e ngastrës kadastrale 00..., në sipërfaqe prej 223 m<sup>2</sup>, duke theksuar se paraardhësit e palëve ndërgjyqëse në vitin 1988 nga H. V. , e kanë blerë paluajtshmërinë PK.nr. ... dhe ..., ashtu që fillimisht paluajtshmëria P.k.nr.... ka qenë e paraardhësit të paditësit H. L. , ndërsa paluajtshmëria P.k.nr.... ka qenë e paraardhësit të paditurit M. L. , po në këtë vite është bërë edhe ndërrimi i këtyre parcelave në mes vëllezërve (paraardhësve të palëve ndërgjyqëse), ashtu që paluajtshmëria P.K.nr.... ka kaluar në pronësi të H. L. , ndërsa paluajtshmëria P.k.nr.... ka kaluar në pronësi të M. L. . Gjithashtu po në atë kohë ka ndodhur edhe biseda për faljen e tokës (pjesa kontestuese- rruga dhe një pjesë-qoshe e paluajtshmërisë fqinje 00...) nga B. T. , E. C. dhe babi i të paditurit, dhe kjo pjesë është falur nga ana e B. T. t pra në kohën sa vëllezërit (paraardhësit e palëve ndërgjyqëse) kanë ndërruar edhe paluajtshmërit në mes vete.

Paraardhësi i paditësit dhe paditësi që nga viti 1989 pa kurrfarë pengese dhe shqetësimi e kanë pasur në shfrytëzim rrugën dhe pjesën e paluajtshmërisë e cila që nga ajo kohë ka qenë e kufizuar.

Ka theksuar se i padituri në vitin 2011, nga tani i ndjeri B. T. , ka blerë paluajtshmërinë fqinje – njësinë kadastrale nr...., në gjendje sic ka qenë e që pjesë e paluajtshmërisë ka qenë rruga, oborri e që nëpër trapin që ka qenë si vijë kadastrale apo kufitare ka qenë gardhi me hunjë metalik, tela me xhamba dhe rrjetë në 2 lisa të mëdhenj, të cilat janë konsideruar si të paditësit. Këtë fakt e ka pasur në njohuri edhe i padituri që nga viti 1988 dhe me rastin e blerjes dhe pranimit në posedim të paluajtshmërisë nga i ndjeri B. T. , ashtu që i padituri e ka blerë paluajtshmërinë duke e ditur se kjo pjesë është e H. L. dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje, dhe i njëjti pas blerjes se parcelës ka marrë gjeodet Z. K. dhe M. S. duke e ftuar edhe babain e paditësit H. L. dhe R. C. dhe kanë vendosur pika, që tani në këto pika të caktuara është edhe parcela kontestuese e të cilat pika janë në përputhje gati të njëjtë me ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë M. L., Tutje ka theksuar se i padituri kundërshtimin e tij e ka bërë në vitin 2021 kur kjo rrugë është shtuar me pllakëza të betonit nga Komuna e Hanit të Elezit.

Gjithashtu i autorizuari e palës paditëse edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë, por edhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka kërkuar që të aprovet padia e paditësit, ngase

janë plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore, mire besimi dhe koha e kaluar, duke theksuar se që me rastin e ndarjes së paluajtsmërisë në mes vëllezërve-paraardhësve të palëve ndërgjyqese, kjo pjesë i ka takuar paraardhësit të paditësit i cili edhe e ka ndërtuar rrugën dhe se paditësi dhe paraardhësi i tij e kanë në shfrytëzim dhe posedim të papenguar për më shumë se 20 vite, andaj edhe e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues konform dispozitave ligjore të nenit 40 par. 1 i Ligjit 03/L-154 si dhe dispozitës e cila ka qenë në fuqi në kodën e krijimit të raportit faktik të posedimit nën 28.4 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike

Shpenzimet i ka kërkuar.

I padituri përmes të autorizuarit të tij me anë të përgjigjes në padi të datës 02.02.2022, gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë si dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke shtuar se i padituri është pronar i njësisë kadastrale kontestuese nr.00..., me anë të kontratës së shitblerjes Vr. Nr. 228/2011, e datës 19.12.2011, e të cilën kontratë deri më sot nuk e ka kundërshtuar askush, duke shtuar se paditësi që nga momenti i ndërrimeve kadastrale nuk ka qenë në posedim, por të njëjtën sipërfaqe e mbanë të uzurpuar pa asnjë të drejtë.

Ka shtuar se është fakt se pjesa e cila shfrytëzohet si oborr i padituri ia njëj të drejtë në pronësisë, por ka theksuar se rruga që nga viti 1988 e shfrytëzuar në fillim nga prindi i të paditurit i cili ishte i vendosur para prindit të paditësit në këto njësi kadastrale, pra edhe me fakte vërtetohet se paditësi nuk ka bazë për njohjen e të drejtës së pronësisë në rrugën e tanishme dhe shtu si pretendon pala paditëse.

Për sa i përket rrugës së shtruar me kubëza, i padituri ka paraqitur një padi në gjykatë ku është paditur Komuna Hani i Elezit ndërsa edhe gjat procedurës kanë propozuar që kjo rrugë të jetë rrugë e përbashkët.

Shpenzimet i ka kërkuar.

### 3.Provat e Administruara në shqyrtimin kryesorë.

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore gjykata bëri administrimin e këtyre provave ku u lexuan: certifikata e pronës me numër ..., ortofotot e vitit 2004, 2009, 2012 dhe 2018, skica e matjeve e vitit 2009 së bashku me pjesën grafike në kopje, ekspertiza gjeodezike e ekspertit M. L. e datës 23.03.2023, së bashku me historiatin e parcelës nr....., deklaratat e dëshmitarëve E. C. , F. V. dhe A. T. , të dhëna në

shqyrtimin gjyqësor të datës 01.11.2023, procesverbali i daljes në vendin e ngjarjes i datës 07.12.2023, fotografitë e vendit të ngjarjes në dy fletë të formatit A4, të dorëzuar nga pala paditëse pa datë të caktuar, fotografitë dhe kopjet e ortofotove të vendit të ngjarjes, në 17 fletë të dorëzuar nga pala paditëse, pajtimi në parim i dorëzuar në formë të shkruar që mbanë datë 03.03.2024, pa pyetje pa vërejtje.

#### 4.Gjendja Faktike

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegjje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lirë të kësaj gjykate, kjo gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Parcela kadastrale 00..., në sipërfaqe prej 4674 m<sup>2</sup>, me kulturë mal klasa e 5, ZK Neqavc, në shërbimin e gjeodezisë regjistrin e të drejtave pronësore evidentohen në emër të të paditurit B. (M.) L. që nga viti 2011, në bazë të kontratës së shitblerjes Vr.Nr..2228/2011 e datës 19.12.2011, ndërsa objekti i kontestit ka qenë sipërfaqaja prej 223m<sup>2</sup> e parcelës kadastrale 00..., kurse paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë në sipërfaqen prej 168m<sup>2</sup>, e cila sipërfaqe përbëhet nga 96m<sup>2</sup> e cila është e shtruar me kubëza betoni dhe 72m<sup>2</sup> sipërfaqe e cila shfrytëzohet si oborr mbi bazën e posedimit, ndërsa pjesa e sipërfaqes kontestuese prej 55m<sup>2</sup> e cila është gërmuar për nivelizimin e rrugës e që po ashtu ishte pjesë e sipërfaqes kontestuese dhe njëherit pjesë e parcelës kad.000... nuk është dëshmuar nga pala paditëse që ka fituar pronësinë me posedim.

Faktin se parcela kadastrale evidentohet që nga vitit 2011 në emër të të paditurit B. L. 1dhe e cila është në përbërje sikurse në certifikatën pronësore nuk ka qenë kontestuese nga palët ndërgjyqëse.

Kontestuese gjatë gjykimit ka qenë sipërfaqja prej 223m<sup>2</sup> te parcelës kadastrale 00... dhe atë sipërfaqja prej 96 m<sup>2</sup> që shfrytëzohet si rrugë, sipërfaqja prej 72 m<sup>2</sup>, që shfrytëzohet si oborr si dhe sipërfaqja prej 55m<sup>2</sup> e cila është gërmuar për nivelizimin e rrugës, kurse gjykata ka gjetur dhe vërtetura se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë në sipërfaqen prej 168m<sup>2</sup>, e cila sipërfaqe përbëhet nga 96m<sup>2</sup> e cila është e shtruar me kubëza betoni dhe 72m<sup>2</sup> sipërfaqe e cila shfrytëzohet si oborr.

Se parcela kadastrale nr. 00..., me kulturë mal klasa e 5, ZK ..., në shërbimin e gjeodezisë evidentohet në emër të të paditurit, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e

ekspertit te gjeodezisë M. L. e datës 23.03.2023, së bashku me historiatin e parcelës nr...., ku ne raportin nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, i datës 22.03.2023, njësia kasastrale 00..., evidentohet ne pronësi të B. L. Inë bazë të kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë V.nr.2228/2011, e datës 19.12.2011.

Edhe pse pasuria kontestuese është evidentuar në emër të të paditurit, sipërfaqja prej 168m2 kontestuese, nuk ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të të paditurit, por ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të paraardhësit të paditësit dhe paditësi që nga viti 1989. Ky fakt është vërtetuar nga deklarata e dëshmitarëve F. V. , i cili ka deklaruar se: *“prona është blerë nga babai i tij dhe se rruga ka ekzistuar që nga viti 1990 dhe është shfrytëzuar nga H. L. , se me rastin e blerjes se pronës, pjesa kontestuese është hapur si rrugë për të hyrë në shtëpinë e H. L. t, ... gjithashtu ka deklaruar se M. L. ka kaluar përmes rrugës kryesore, gjithashtu nga deklarata e dëshmitarit E. C. , i cili ka deklaruar se në këtë pjesë ka qenë përrua, e më vonë e kane rrafshuar për ta shfrytëzuar si rrugë.. se babi i tij ka kërkuar nga B. T. të i mundësohet qasje banorëve të asaj pjese, familjes Laçi”*, si dhe nga ekspertiza e ekspertit te gjeodezisë M. L. se bashku me ortofotot e vitit 2001, 2004, 2009, 2012, 2018, në të cilat shihet që kalon rruga nëpër parcelën ...,

Nga procesverbali i vendshiqimit të datës 07.12.2023 vërtetohet se objekt kontesti është pjesa e parcelës ... Z.k Neqavc, ku një pjesë prej 72 m2 përdoret si oborr, ku në pjesën perëndimore përkatësisht gjatë rrugës kryesore është e rrethuar me tela dhe gypa metalik, gjithashtu objekt kontesti është edhe sipërfaqja prej 96 m2, e cila shfrytëzohet si rrugë, e shtruar me kubëza betoni si dhe sipërfaqja prej 55m2 është tokë e gdhendur, pjesë e gjermuar që vazhdon deri në nivelizimin e rrugës me kubëza betoni.

I padituri e ka ditur se kjo pjesë është në shfrytëzim te paditësit dhe asnjë here nuk e ka kërkuar lirimin e tyre, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat e paraqitura në padi, ku në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se i padituri ne vitin 2011 e ka blerë këtë paluajtshme nga B. T. ne gjendjen siç ka qene, e që një pjesë e paluajtshmërisë ka qenë rruga, oborri e që nëpër trap qe ka qenë si vijë kadastrale apo kufitare, ka qenë gardhi m e hunj metalik, tela me gjemba dhe rrjetë, në dy lisa te mëdhenjtë që janë konsideruar të paditësit, e po ashtu ne këtë pjesë janë vendosur kanalizimi fekal, ujësjellësi privat i paraardhësit të paditësit, kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga ortofotot e vitit 2001, 2004, 2009, 2012, 2018, deklarata e dëshmitarit A. T. , i cili e ka deklaruar së ai së bashku me vëllain e tij B. T., ia kanë shitur parcelën Bajramit- të paditurit dhe rrugën rreth shtëpive që është në formë të trekëndëshit-

pjesën kontestuese nuk ia kanë llogaritu në çmim, pasi që kjo pjesë është falur nga babi i tij për shfrytëzim si rrugës para 30-40 viteve për babin e B., , gjithashtu nga historiat i parcelës vërtetohet fakti se në vitin 2011 në bazë të kontratës së shitblerjes Vr.nr.2228/2011 e datës 19.12.2011, parcela ..., kalon në pronësi të B. L., e që në dosjen e ndarjes fizike të parcelës 315-0 si dhe manualin e parcelave fqinje, në pjesën kontestuese është përshkruar me vijë të zeze një ndryshim i kufirit po që nuk është regjistruar në sistemin kadastral, e gjithashtu me rastin e blerjes së kësaj paluajtshmërie, i padituri ka marrë gjeodet Z. K.dhe M. S., duke e ftuar edhe babin e paditësit H. L. dhe R. C. dhe kanë vendosur pikat, e të cilat pika janë në përputhje të njëjtë me ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë M. L..

Po ashtu edhe nga “pajtimi në parim”, i arritur në mes palëve ndërgjyqese, ku theksohet se “në si familjarë jemi marr vesh që prona me numër ... me pronën 317-4, që kemi pasur deri me tani të zgjidhen me marrëveshje dhe me pika e reja që i ka bërë gjeodeti M. L., pra kockat ku janë shtruar mos të preken fare...., gjykata deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i ka udhëzuar palët për zgjidhjen e qështjes në procedurë të ndërmjetësimit apo me marrëveshje gjyqësore dhe për më tepër në fund të shqyrtimit gjyqësor gjykatës i është ofruar kjo kopje e nënshkruar nga të dyja palët për pajtim, mirëpo i padituri pak para se gjykata ta aprovon marrëveshjen e palëve dhe qështjen ta zgjidh me pajtim gjyqësor ka theksuar se dëshiron që rrugën e cila është e shtruar me kubëza betoni ta kenë në pronësi të përbashkët, e gjykata duke e parë se në këtë qështje nuk ekziston vullneti i tërësishëm për zgjidhjen e qështjes, atëherë ka vazhduar me administrim të provave për hir të ekonomizimit të procedurës pasi që disa here ka aprovuar kërkesën e palëve për shtyrje të seancave me qëllim që qështjen ta përfundojnë me pajtim gjyqësorë.

## 5. Konkluzionet e gjykatës

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe deklaratave të dëshmitarëve, kërkesëpadinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe paditësit ia njohu të drejtën e pronësisë, paditësi në këto pjesë e ka fituar të drejtën e pronësisë, sepse të njëjtat i ka në shfrytëzim me mirëbesim dhe në të njëjtat e ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje sepse i ka në posedim që nga viti 1989, e deri me tani i pa penguar nga askush as nga të paditurit, dhe janë plotësuar kushtet nga nenit 40 par.1 të LPDTS-së ku thuhet se: *Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të”*.

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartcekura, gjykata vjen në përfundim se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese mbi bazën e parashkrimit fitues, pasi që paditësi ka qenë mbajtës me mirëbesim i paluajtshmërisë kontestuese më tepër se 20 vite, pa u penguar nga askush, andaj gjykata bazuar në dispozitat e lartcekura dhe faktin e posedimit të paditësit, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata e refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit në lidhje me fitimin e të drejtës së pronësisë në pjesën prej 55m<sup>2</sup> të par.kad.00...e cila aktualisht përbën sipërfaqen e gërmuar për nivelizimin e rrugës pasi që paditësi nuk ka ofruar prova bindëse me të cilat do të dëshmohet se edhe këtë pjesë e ka pasur në posedim me mirëbesim dhe të pa ndërprerë pasi që nga dalja në vengjarje e gjykatës vërehet se pjesa e gërmuar për nivelizim nuk i ka shërbyer opsionit të rrugës, por është në hapësirën e të paditurit dhe nuk ekzistojnë prova që kjo pjesë të jetë shfrytëzuar nga paditësi me të gjitha kushtet e mirëbesimit, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e te autorizuarit te paditësit i cili i propozoi gjykatës qe kerksepadine e paditesit ta miratoje ne teresi si te bazuar dhe ta vertetoje se paditesi e ka fituar te drejten e pronesise membajtje me mirebesim, fakt i veretteuar nga deklarata e deshmitareve dhe nga vet deklarata e te paditurit A. K., prandaj gjykata pjesërisht ia dha besimin këtyre pretendimeve dhe duke e marr për baz keto fakte vendosi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të paditurit i cili i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar sepse prona është e tij , mirëpo këto theksime gjykatat nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse paditësi në këtë pasuri e ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje me mirëbesim sepse të njëjtat i ka në posedim dhe shfrytëzim i pa penguar nga askush e as nga e paditura në raport me pjesën e cila shfrytëzohet si oborr dhe pjesën e cila shfrytëzohet si rrugë, për më tepër i padituri nuk ka ofruar prova me të cilat do ta dëshmonte që këto pjesë të parcelës kanë qenë apo vazhdojnë të jenë në posedim të pandërprerë nga ana e të paditurit, përveq faktit se parcelën e ka blerë nga vitit 2011 në aspektin juridik, por jo edhe në atë faktik.

Gjykata në lidhje me shpenzimet e procedurës kontestimore, konstatoi se pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore me rastin e dorëzimit të padisë në Gjykatë në lartësi prej 20€ dhe e njëjta është në përputhje me Udhëzimin Administrativ 01/2017, ndërsa vendimin për shpenzimet, Gjykata e ka bazuar në nenin 450. të LPK-së.



Gjykata vendosi që secila palë ti përballon shpenzimet e krijuara procedurale, duke marrë parasysh se pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia dhe vendosja në lidhje me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.2 të LPK-se ku thuhet se: “ *Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve. 452.3 Gjykata mund të vendos që njëra palë t’i shpërblej të gjitha shpenzimet që kanë pasur pala kundërshtare dhe ndërhyrësi që i është bashkuar, në qoftë se pala kundërshtare nuk ka pasur sukses vetëm në pjesën proporcionalisht të pa rëndësishme të kërkesës së vet, kurse për shkak të kësaj pjese nuk janë krijuar shpenzime të veçanta”*

Siç u theksua më lartë, dhe në bazë të rezultatit të tërë procedurës lidhur me çështjen kontestimore juridiko–civile, kjo gjykatë gjykoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

C.nr. 2021:221135, datë 05.06.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.